



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Në mbështetje të nenit 150 të Statutit të OAK-së Këshilli Drejtues i OAK shpallë

K O N K U R S- ri shpallje
Për vend të lirë të punës

Pozita: Prokuror Disiplinor i OAK
Koeficienti: 10

I. Kushtet:

Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Fakultetin Juridik (katërvjeçar ose bachelor + master)
2. 3 vjet përvojë punë në pozita të ngjashme
3. të ketë të dhënë provimin e jurisprudencës
4. Njohja e punës me kompjuter (Programet e Windows-it) e obligueshme
5. Njohja e gjuhëve zyrtare (njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme)
6. **Dëshmi nga e kaluara penale**

Të kandidatët do të vlerësohen: afinitetet, kreativiteti, shkathhtësitë profesionale, aftësia për të përballuar punën nën presion.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT:

1. për pranimin dhe shqyrtimin e çdo fletëparaqitje ndaj avokatit apo praktikantit të avokatisë duke përfshirë iniciimin dhe shqyrtimin ex-officio te rastit;
2. për përcaktimin nëse Zyra e prokurorit disiplinor ka juridiksion ndaj çështjes;
3. për hetimin e çdo fletëparaqitje, ndaj të cilës ka juridiksion;
4. për raportimin e rezultateve të hetimit në Komisionin disiplinor;
5. në rastet kur Zyra e prokurorit disiplinor përcakton ekzistimin e arsyes së bazuar për ndjekje disiplinore, për përfaqësimin e interesave të OAK-ut në ndjekjen disiplinore të çështjes para Komisionit disiplinor.
6. Paraqitja e ankesave kundër vendimeve të shkallës së parë kur konsideron se ka arsye të bazuar
7. Kryen punë tjera të ngarkuara nga Drejtori Ekzekutiv

KOHËZGJATJA E PUNËSIMIT:

Periudha provuese prej 6 (gjashtë) muaj.

DATA E MBYLLJES SË KONKURSIT:

Konkursi është i hapur shtatë (8) ditë prej ditës së shpalljes në gazetatat lokale dhe në web faqen e Odës së Avokatëve të Kosovës www.oak-ks.org. Afati i fundit është më datë 05/11/2020 në ora 16:00.

PARAQITJA E APLIKACIONIT:

Aplikacionet merren në ëeb faqe të OAK-së dhe dorëzohen në zyrat e Odës së Avokatëve të Kosovës, Rr. "Bedri Pejani" nr. 31, Prishtinë.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kandidatët të cilën hynë në listën e ngushtë, për testim dhe intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, rr. Bedri Pejani nr.31

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të na drejtohen me anë të E-mail adresën: info@oak-ks.org ose në numrat e telefonit: 038/244-586 dhe 038/243-717, prej orës 08:00 – 16:00.

Kërkesat e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.